



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Pursuant to instruction of the Single Judge KSC-BC-2020-07/CRSPD4 of 15 October 2020, reclassified as PUBLIC.

Numri: KSC-BC-2018-01

Vendos: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe ex parte

Njoftim i pranimit të Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit të Dhomave të
Specializuara

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

1. Në bazë të rregullës 10.2 të Rregullores së Paraburgimit¹, pas pranimit të një të paraburgosuri në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, shefi i paraburgimit njofton pa vonesë Administratorin i cili u dërgon autoriteteve gjyqësore përkatëse njoftimin e pranimit dhe informon palët dhe personat përkatës, ndër të cilët edhe shefin e Zyrës së Mbrojtjes.
2. Në përputhje me këtë, Administratorja dërgon në vijim shtojcën me njoftimin e pranimit të z. Hysni Gucati ('z. Gucati') në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë. Njoftimin e pranimit Administratorja ia ka dërguar edhe shefit të Zyrës së Mbrojtjes.
3. Në pritje të emërimit ose caktimit të mbrojtësit në pajtim me pjesën 12 të Direktivës për Mbrojtësit, Administratorja informon gjithashtu gjykatësin e vetëm për caktimin e znj. Tamara Buruma si mbrojtëse kujdestare të z. Gucati në përputhje me pjesën 17(2) të Direktivës për Mbrojtësit dhe rregullën 21 të Rregullores së Ndihmës Juridike.²
4. Ky njoftim i pranimit dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në pajtim me klasifikimin aktual të KSC-BC-2018-01/F00128.³

Numri i fjalëve në origjinal: 240

/nënshkrim/

Dr. Fidelma Donlon
Administratore

E enjte, 25 shtator 2020
Në Hagë, Holandë

¹ Rregullorja e Paraburgimit, KSC-BD-08-Rev1, 23 shtator 2020.

² Direktiva për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017; Rregullorja e Ndihmës Juridike, KSC-BD-25, 3 shtator 2020. *Shih gjithashtu* Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020, rregulla 26.

³ Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2018-01/F00128, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.